**Republika e Kosovës**
**Republika Kosova – Republic of Kosovo**

**ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT**
**TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE**
**PROCUREMENT REVIEW BODY**

REPUBLIKA E KOSOVËS ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
Nr./Br. 336/19
Datë/Datum 06.08.2019
PRISHTINË - PRIŠTINA

---

**PSH.nr. 336 /19**

**PANELI SHQYRTUES**, i emëruar nga kryetari në bazë të nenit 105 dhe nenit 106 të Ligjit për Prokurim Publik të Kosovës nr. 04/L-042,i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/ L-068, dhe Ligjin 05/ L-092, në përbërje: z.Nuhi Paçarizi- Kryetar, z.Blerim Dina- Referues, z.Goran Milenković - Anëtar, duke vendosur sipas ankesës së parashtruar nga operatori ekonomik:"Euro-Ing"Prishtinë kundër njoftimit për dhënie te kontratës ku i rekomanduar për dhënie te kontratës është OE "N.T.N. B&D ENGINEERIG", lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: "Furnizimi me gjysmfabrikate (disqe) për punimin e dhëmbezorve" me nr. prokurimi 19-810-1-2-1të iniciuar nga AK- Korporata Energjetike e Kosovës- KEK më datën: 25.07.2019 mori këtë:

## V E N D I M

I.**APROVOHET**, pjesërisht si e bazuar ankesa e operatorit ekonomik: "Euro-Ing" Prishtinë "-lidhur me aktivitetin e prokurimitme titull"Furnizimi me gjysmfabrikate (disqe) për punimin e dhëmbezorve" me nr.prokurimi 19-810-1-2-1të iniciuar nga AK- Korporata Energjetike e Kosovës- KEK .

II.**ANULOHET** , njoftimi për dhënie te kontratës lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: "Furnizimi me gjysmfabrikate (disqe) për punimin e dhëmbezorve'' me nr.prokurimi 19-810-1-2-1 të iniciuar nga AK- Korporata Energjetike e Kosovës- KEK dhe aktiviteti i prokurimit në fjalë kthehet në **Rivlerësim.**

III. Autoriteti Kontraktues në afat prej 10 ditësh duhet ta informoj me shkrim Panelin Shqyrtues për të gjitha veprimet e ndërmarra lidhur me këtë aktivitet të prokurimit.

IV.Mos respektimi i këtij vendimi, detyron Panelin shqyrtues që konform dispozitave ligjore të nenit 23.9 dhe 131 të Ligjit për Prokurim Publik të Kosovës nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/ L-068, dhe Ligjin 05/ L-092, të ndërmarr masa ndaj Autoritetit Kontraktues.

**V.**Me qenë se ankesa e operatorit ekonomik ankues "Euro-Ing"aprovohet pjesërisht si e bazuar, i bëhet kthimi i tarifës së ankesës në shumën e deponuar me rastin e parashtrimit të ankesës.

**VI.**Obligohet operatori ekonomik ankues që konform nenit 33 pika 6 të rregullores së punës së OSHP-së, në afat prej gjashtëdhjetë (60) ditësh të bëjë kërkesë për kthim të sigurimit të ankesës, në të kundërtën ju bëhet konfiskimi i depozitës dhe këto mjete kalojnë në Buxhetin e Republikës së Kosovës.

## ARSYETIM

Njoftimi për kontratë në lidhje me këtë aktivitet të prokurimit është bërë me dt:04.03.2019

Hapja e ofertave është bërë me dt: 27.03.2019

Kundër njoftimit për eliminim operatori ekonomik:"EURO-ING SHPK"Prishtinë me dt: 10.06.2019, ka bërë kërkesë për rishqyrtim tek autoriteti kontraktues

Autoriteti Kontraktues me datën : 11.06.2019 ka marrë vendim që të refuzohet kërkesa për rishqyrtim e OE:"EURO-ING SHPK"Prishtinë

Operatori ekonomik ankues "EURO-ING SHPK"Prishtinë si palë e pa kënaqur, ka deponuar ankesë në OSHP, me24.06.2019 me nr. 336/19,kundër njoftimit për dhënie te kontratës lidhur me aktivitetin të prokurimit me titull "Furnizimi me gjysmëfabrikate (disqe) për punimin e dhëmbezorve''me nr prok: 336/19,të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) "Korporata Energjetike e Kosovës- KEKduke pretenduar se AK ka bere shkelje te këtyre dispozitave te LPP-së:

- Shkelje e nenit 1Ligjit për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës,
- Shkelje e nenit 6Ligjit për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës,
- Shkelje e nenit 7Ligjit për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës,
- Shkelje e nenit 59Ligjit për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës,
- Shkelej e nenit 60 të Ligjit për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës
- vendimi i OSHP-ë PSH nr. 336/18

Organi Shqyrtues i Prokurimit, konform nenit 113 dhe 114 të LPP-së me datë: 25.06.2019ka autorizuar ekspertin shqyrtuesprofesional tëprokurimit për të shqyrtuar vlefshmërinë e të gjitha pretendimeve të palës ankimore.

Eksperti Shqyrtuesprofesional në raportin e dt:02.07.2019,lidhur me pretendimin ankimore te OE-ankues"EURO-ING SHPK" "-Prishtinë ,jep këtopërgjigje në pretendimet ankimore të grupit të OE ankues "EURO-ING"ShPK.

Përgjigje në Pretendimin 1.

Lidhur me pretendimin e grupit OE "EURO ING"SHPK se AK gjatë vlerësimit të ofertave ka propozuar ofertën e OE N.T.N"B&D ENGINEERING"si ofertë fituese(ofertë me e lirë) edhe pse ky operator duhet të shpallet i papërgjegjshëm sepse nuk ka plotësuar Kërkesat mbi mundësitë teknike dhe/ose profesionale të parashikuara me nein 9.1&9.2 ku është kërkuar "1.Autenciteti i produkteve dhe cilësisë reprezentues, ndërsa si dëshmi e kërkuar dokumentare është kërkuar"1.Autorizim nga prodhuesi ose dileri i autorizuar(nëse është nga dileri atëherë si dëshmi të sillet kontrata ose autorizim mes dilerit dhe prodhuesit, eksperti shqyrtues ka këtë mendim.

OE N.T.N"B&D ENGINEERING" i propozuar si fitues i mundshëm i këtij aktiviteti të prokurimit ka dorëzuar një letër Autorizim nga dileri "Metal element" që autorizon OE "B&D Engineering"ta merr pjesë në këtë aktivitet të prokurimit dhe ky diler(Metal Element) në letër Autorizim është partner me prodhuesin "Euro Sider Scalo"por që nuk dëshmohet me kontratë apo autorizim të kërkuar sipas kërkesës së Dosjes së tenderit.

Konsideroj që pretendimi i grupit të OE ankues është i bazuar

Përgjigje në Pretendimin 2.

Lidhur me pretendimin e grupit OE "EURO ING"SHPK se AK gjatë vlerësimit të ofertave ka propozuar ofertën e OE N.T.N "B&D ENGINEERING"si ofertë fituese(ofertë me e lirë) është i papërgjegjshëm për faktin se nuk i ka plotësuar kërkesat mbi mundësitë teknike dhe/ose profesionale të parashikuara me nenin 9.1 dhe 9.2 ku është kërkuar certifikatë të produkteve në lidhje me përshtatjen dhe specifikat ose standardet ku si dëshmi është kërkuar Certifikimi i prodhuesit sipas ISO 9001 2015,konsideroj që OE N.T.N"B&D ENGINEERING" i propozuar si fitues i mundshëm ka dorëzuar certifikatën ISO 9001:2015 e cila ka validitet dhe i përmbush kërkesat nga dosja e tenderit.Konsideroj që pretendimi i OE ankuesështë

i pa bazuar.

Përgjigje në Pretendimin 3.

Lidhur me pretendimin e grupit OE "EURO ING"SHPK se AK gjatë vlerësimit të ofertave ka propozuar ofertën e OE N.T.N"B&D ENGINEERING"si ofertë fituese(ofertë me e lirë) dhe ky OE nuk ka ofruar specifikim për secilin artikull siç është kërkuar në dosjen e tenderit "Dokumentacioni autentik i prodhuesit katalog i prodhuesit të produkteve në dokumentacionin e saj,konsideroj që OE N.T.N"B&D ENGINEERING ka ofruar dokumentacion/dëshmi të mjaftueshme mbi specifikat e artikujve siç është kërkuar në dosjen e tenderit.

Konsideroj se pretendimi është i pa bazuar.

Konstatojmë se pretendimet ankimore janë pjesërisht të bazuara

Mendimi i ekspertit shqyrtues

Në bazë të sqarimeve të lartpërmendura, eksperti shqyrtues i propozon panelit shqyrtues që ankesa e OE ankues të pranohet pjesërisht për arsyen që i theksuam në përgjigjeje të pretendimit ankimore të më sipërm.

Eksperti shqyrtues në përputhje me nenin 114 pika 2 të LPP-së rekomandon autoritetin kontraktues që ta RIVLERËSOJ aktivitetin e prokurimit "Furnizimi me gjysumfabrikate (disqe) për punimin e dhëmbzorve" me nr.prokurimi 19-810-1-2-1.

Autoriteti kontraktues përmes parashtresës me shkrim të datës: 05.07.2019, ka njoftuar Panelin shqyrtues se nuk pajtohet më raportin e ekspertit shqyrtues.

Operatori Ekonomik përmes parashtresës me shkrim të datës: 03.07.2019, ka njoftuar Panelin shqyrtues sepajtohetmë raportin e ekspertit shqyrtues.

Në seancën e shqyrtimit kryesor të datës 25.07.2019, ku kanë qenë prezent paneli shqyrtues,përfaqësuesi i OE ankues, Autoriteti Kontraktues ku u shqyrtuan shkresat e lëndës duke e bërë kontrollimin dhe analizimin e dokumentacionit për procedurën e prokurimit i cili përbëhet nga: autorizimi i inicimit të

aktivitetit të prokurimit, njoftimi për kontratë, ankesa e operatorit ekonomik, raporti i ekspertit shqyrtues, parashtresat e palëve në procedurë.

Gjatë prezantimit në seancë përfaqësuesi i OE-së ankues z. Fetoshi i cili deklaroj: Ne me mendimin e ekspertit jemi pajtuar vetëm me konstatimin nr 1 ndërsa ne te 2 te tjerat nuk jemi pajtuar. Sa i përket konstatimit nr 1. Është vërtetuar dhe konstatuar edhe nga eksperti i OSHP-së qe OE i rekomanduar është i papërgjegjshëm dhe nuk e plotëson kërkesën e FDT-së sepse nuk ka ofruar dëshmi konkretisht kontrate ndërmjet dilerit dhe prodhuesit ashtu siç është kërkuar ne nenin 9.1 dhe 9.2 te FDT-së . ne konsiderojmë se OE i rekomanduar është i papërgjegjshëm edhe për 2 arsye te tjera sepse ne ISO certifikatën 9001/2015 te këtij OE shkruan se është vetëm për prerje te metalit te karbonit ndërsa nuk shkruan qe është për prodhimin e materialeve siç është kërkuar ne FDT. Po ashtu konsiderojmë qe është i pa përgjegjshëm OE i rekomanduar sepse nuk ka ofruar edhe përshkrimet teknike për te gjitha pjesët – produktet prandaj konform nenit 39 te RrUOPP-së ky OE duhet te konsiderohet i papërgjegjshëm dhe nuk mund te kërkohen sqarime shtesë ne këtë rast

Gjatë prezantimit në seancë përfaqësuesi i AK-së z. Mexhuani i cili deklaroj: Tek pika 1 sa i përket kontratës ne e kemi vërejtur, kontrata nuk është por është një përshkrim i autorizimit qe ethe e arsyeja ka qen se është edhe çmimi 36.285 për OE qe kemi propozuar për kontratë ndërsa ankues është me i shtrenjtë. Sa i përket certifikatës ISO ne kemi kërkuar ISO 2009/2015 nuk e kemi cek për çfarë është por vetëm prodhuesi. Për piken 3 tek spec.teknike mundet me shquar te gjitha kërkesat i përmbush katalogu i OE qe ka prezantuar. Ne nuk e di se çka OE ka menduar se si fi 50 dhe si fi 1000 edhe ai nuk mundur me pas çmimin te njëjtë, e krejt çmimet për te gjithë artikujt i ka te njëjtë.

Në fjalën përfundimtare përfaqësuesi i OE-së deklaroj: kërkojmë nga paneli qe te aprovohet ankesa jone si e bazuar dhe ky AP te kthehet ne rivlerësim

Në fjalën përfundimtare përfaqësuesi i AK-së deklaroj: kërkoj qe ky AP ti jepet OE me çmim me te lire apo te ri tenderohet ky AP .

Paneli shqyrtues pas shqyrtimit të shkresave të lëndës, shqyrtimit të pretendimeve ankimore të OE ankues, konstatimeve, analizës konkrete dhe rekomandimeve të ekspertit shqyrtues profesional , deklarimit të palëve në procedurë, diskutimeve dhe shoshitjes së provave në tërësi gjatë seancës për shqyrtim kryesor, sqaron se ankuesi pretendon se AK gjatë vlerësimit të ofertave ka propozuar ofertën e

OE N.T.N"B&D ENGINEERING" si ofertë fituese(ofertë me e lirë) edhe pse ky operator duhet të shpallet i papërgjegjshëm sepse nuk ka plotësuar Kërkesat mbi mundësitë teknike dhe/ose profesionale të parashikuara me neni 9.1&9.2 ku është kërkuar "1.Autenciteti i produkteve dhe cilësisë reprezentues, ndërsa si dëshmi e kërkuar dokumentare është kërkuar"1.Autorizim nga prodhuesi ose dileri i autorizuar(nëse është nga dileri atëherë si dëshmi të sillet kontrata ose autorizim mes dilerit dhe prodhuesit.

Paneli shqyrtues konform ekspertit shqyrtues profesional për pretendimin e lart cekur konstaton se OE N.T.N"B&D ENGINEERING" i propozuar si fitues i mundshëm i këtij aktiviteti të prokurimit ka dorëzuar një letër Autorizim nga dileri "Metal element" që autorizon OE "B&D Engineering" te merr pjesë në këtë aktivitet të prokurimit dhe ky diler (Metal Element) në letër Autorizim është partner me prodhuesin "Euro Sider Scalo"por që nuk dëshmohet me kontratë apo autorizim të kërkuar sipas kërkesës së Dosjes së tenderit. Andaj nga ky fakt konstatojmë se pretendimi i grupit të OE ankues është i bazuar

Lidhur me pretendimin e grupit OE "EURO ING"SHPK se AK gjatë vlerësimit të ofertave ka propozuar ofertën e OE N.T.N "B&D ENGINEERING" si ofertë fituese(ofertë me e lirë) është i papërgjegjshëm për faktin se nuk i ka plotësuar kërkesat mbi mundësitë teknike dhe/ose profesionale të parashikuara me nenin 9.1 dhe 9.2 ku është kërkuar certifikatë të produkteve në lidhje me përshtatjen dhe specifikat ose standardet ku si dëshmi është kërkuar Certifikimi i prodhuesit sipas ISO 9001 2015.

Paneli shqyrtues konform ekspertit shqyrtues profesional konstatojmë se OE N.T.N"B&D ENGINEERING" i propozuar si fitues i mundshëm ka dorëzuar certifikatën ISO 9001:2015 e cila ka validitet dhe i përmbush kërkesat nga dosja e tenderit. Andaj edhe pretendimi i OE ankues për ketë pikë është i pa bazuar.

Lidhur me pretendimin e grupit OE "EURO ING"SHPK se AK gjatë vlerësimit të ofertave ka propozuar ofertën e OE N.T.N"B&D ENGINEERING" si ofertë fituese(ofertë me e lirë) dhe ky OE nuk ka ofruar specifikim për secilin artikull siç është kërkuar në dosjen e tenderit "Dokumentacioni autentik i prodhuesit katalog i prodhuesit të produkteve në dokumentacionin e saj.

Paneli shqyrtues konform ekspertit shqyrtues profesional konstaton se OE N.T.N"B&D ENGINEERING ka ofruar dokumentacion/dëshmi të mjaftueshme mbi specifikat e artikujve siç është kërkuar në dosjen e tenderit, andaj edhe pretendimin në fjalë është i pa bazuar.

Paneli shqyrtues vjen në përfundim se ekzaminimi vlerësimi dhe krahasimi i tenderëve nuk është bërë konform nenit 59 dhe 72 të LPP-së dhe njëkohësisht nuk është respektuar edhe neni 60 i LPP-së kriteri kryesor për dhënie të kontratës e që ka qenë tenderi i përgjegjshëm me çmim më të ulët.
Prandaj obligohet autoriteti kontraktues që gjatë rivlerësimit të ofertave dhe në të ardhmen ti përmbahet në detaje të gjitha dispozitave të LPP-së dhe kërkesave të dosjes së tenderit dhe të njoftimit për kontratë.

Paneli shqyrtues konform nenit 117 të LPP-së, si dhe duke u bazuar në provat e prezantuara si më lart vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

**KËSHILLË JURIDIKE:**
Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa, por pala e pakënaqur me kërkesëpadi mund t'i drejtohet vetëm Gjykatës themelore-Departamentit për çështje Administrative për kompensim dëmi ne afat prej 30 ditësh nga data e pranimit të vendimit .

Kryesuesi i Panelit Shqyrtues

Nuhi Paçarizi

**Vendimi t'i dorëzohet:**
1x1 AK -Korporata Energjetike e Kosovës- KEK
1x1 OE- Euro-Ing" Prishtinë
1x1 Arkivës së OSHP-së;
1x1 Për publikim në ueb- faqe të OSHP-së.